



HISTORIKU I TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE TË KRIMIT NË KOSOVË

HYRJE

Lëvizja për mbrojtjen e të drejtave të viktimave në Kosovë filloi qysh menjher në periudhën e pasluftës në Kosovë. Problemet shoqërore u bënë më të dukshme në kohën e pasluftës, ku një vend i vogël si Kosova filloi rrugëtimin e saj për t'u pavarësuar si shtet dhe kalonte nëpër një periudhe tranzicioni. Me ndihmën e prezencës së shumë organizatava ndërkombëtare që u vendosën në Kosovë pas vitit 1999, të cilat vepruan në sfera të ndryshme në zhvillimin dhe ndërtimin e një vendi të dalë nga lufta, institucionet tona filluan të ofronin ndihmë viktimave të krimit. Gjatë kësaj periudhe operuan organizata ndërkombëtare që asistuan gratë dhe fëmijët që kishin dhunë në familje, gratë dhe vajza të reja cilat transportoheshin nga vende tjera të Europës në Kosovë për qëllime të shfrytëzimit seksual, gratë e dhunuara gjatë luftës dhe raste të tjera të ngjashme. Këto fenomene shoqërore shiheshin si dukuri të panjohura për vendin tonë, dhe rrjedhimisht edhe mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimave të krimit ishte e mangët. Me kalimin e kohës disa gra aktive formuan organizata joqeveritare të cilat filluan të strehonin viktimat, dhe të cilat me ndihmën e fondeve dhe ekspertizës së ofruar nga organizatat ndërkombëtare filluan edhe të pasurojnë njohuritë e tyre për dhunën në familje dhe trafikimin me njerëz. Gradualisht këto organizata të grave u shëndrruan në strehimore edhe filluan të ofronin shërbime më kualitative për këto kategori të viktimave. Ndërkohë, me formimin e Policisë së Kosovës, u themeluan edhe njësitet e posaçme për dhunën në familje dhe anti-trafikim, të cilët u specializuan për trajtimin dhe reagimin ndaj këtyre

rasteve. Ndërkohë u formuan mekanizmat dhe infrastruktura institucionale dhe ligjore për luftimin e trafikimit me njerëz dhe dhunën në familje dhe ofrimi i mbrojtjes për viktimat e krimit. Në vitin 2001, hyri në fuqi rregullorja e UNMIK-ut¹ për luftimin e trafikimit dhe në 2003 rregullorja për mbrojtjen nga dhuna në familje. Në vitin 2002 u formua edhe njësi i Mbrojtësve të Viktimave në Kosovë, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, të cilët fillimisht kaluan nëpër një proces të trajnimit dhe më pas filluan t'iu ofronin mbështetje viktimave të trafikimit me njerëz, viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të abuzimit seksual. Mbrojtësit e Viktimave ishin një hap i madh dhe i rëndësishëm drejt mbrojtjes së të drejtave të viktimave të krimit në Kosovë, dhe vazhdojnë të jenë hallka më e rëndësishme e sistemit të drejtësisë, sa i përket parandalimit të shkeljes së të drejtave të viktimës përgjatë procedurave gjyqësore dhe kontaktit me zbatuesit e ligjit. Më poshtë do të gjeni informata më të hollësishme për sistemin dhe rolin e mbrojtësve të viktimave në Kosovë.

Kosova edhe pse një vend i vogël dhe shtet i sapoformuar, ka ndërmarrë hapa të mëdha në përmbushjen e obligimeve të saj ndaj viktimave të krimit. Viteve të fundit Kosova ka ndërmarrë hapa drejt avancimit të legjislacionit për mbrojtjen e viktimave të krimit, duke formuar mekanizma institucional, njësite të specializuara, duke adoptuar ligje dhe politika të ndryshme të cilat gjithmonë e vendosnin viktimën në qendër të vëmendjes

¹UNMIK- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, që gjatë periudhës 1999-2008 kishte kompetenca ekzekutive në funksionimin e institucioneve shtetërore në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në 2008 kompetencat e UNMIK janë zbehur. UNMIK ende vazhdon prezencën në vend, por me një status neutral.

duke i njohur të drejtat dhe nevojat e saj me qëllim të ofrimit të mbështjetjes adekuate. Andaj, kjo broshurë ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë rreth të gjitha këtyre përpjekjeve që Kosova i ka bërë në drejtim të mbrojtjes së viktimave të krimit. Në mënyrë kronologjike janë listuar institucionet, programet, mekanizmat, ligjet dhe instrumentet tjera udhëzuese për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit. Së fundmi, kjo broshurë përveç se mund të shërbejë si një përmbledhje e shkurtër e historikut të vendit tonë në zhvillimin dhe përmirësimin e të drejtave të viktimave të krimit, poashtu mund të shërbejë si broshurë informative për infrastrukturën ekzistuese ligjore dhe institucionale. *Shënim: Lista mund të mos i përmbajë të gjitha veprimet që Kosova i ka ndërmarrë në këtë fushë përgjatë këtyre viteve.*

1999

Policia së Kosovës- Njësitë për Dhunë në Familje dhe Njësitë kundër Trafikimit me Njerëz (THB)

Policia e Kosovës është themeluar në shtator të vitit 1999, ku është hapur shkolla e policisë dhe janë trajnuar kandidatët për pjesëtarë të Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës më vonë e themelon njësitin për dhunë në familje dhe njësitin kundër trafikimit me qenie njerëzore. Policia e Kosovës në të shumtën e rasteve është kontakti i parë me viktimën. Njësitë për trafikimin me njerëz identifikon viktimat, heton rastin dhe mbron viktimat e kësaj kategorie. Njësitë i dhunës në familje është poashtu i specialiaur në fushën e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, reagimet në vendin e ngjarjes, identifikimin e kryesit të dhunës në familje, hetimin e rastit dhe shoqërimin e viktimës në shërbime të strehimit, mjekësore dhe të tjera me qëllim të mbrojtjes së viktimës.

Themelimi dhe funksionimi i Strehimoreve të Kosovës për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit me njerëz

Strehimoret në Kosovë janë hapur pas periudhës së luftës me iniciativën e grave të cilat janë mbështetur nga organizata ndërkombëtare që kishin filluar të veprojnë në Kosovës pas vitit 1999 dhe që kishin identifikuar nevojën urgjente për të strehuar gra dhe fëmijë. Strehimoret ofronin shërbime strehimi, mbrojtjeje, rehabilitimi dhe reintegrimi për gratë dhe

fëmijët viktimë të dhunës në familje, dhunës seksuale, incestit, trafikimit me njerëz dhe forma tjera të dhunës. Në atë kohë janë themeluar strehimoret në Prishtinë, Gjakovë, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë, të cilat shumë vite më pas do ta formonin edhe Koalicionin e këtyre strehimoreve. Strehimoret e Kosovës pjesërisht financohen nga fondet e e Ministrisë së Punës dhe Mirëqënies Sociale, e cila ndanë grante për organizatat që ofrojnë shërbime sociale për viktimat e krimit. Megjithatë, strehimoret tash e disa vite vazhdimisht ballafaqohen me vështësi financiare dhe çdo vit rrezikohen të mbyllen për shkak të mungesës së gjenerimit të mjeteve financiare të mjaftueshme për t'i shërbyer viktimave.

2001

Rregullorja e UNMIK-ut për ndalimin e trafikimit me njerëz

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë përbënte bazën dhe legjislacionin e veçantë për ndjekjen dhe ndëshkimin e kryesve të krimeve të trafikimit me njerëz dhe veprave tjera të ngjashme si dhe ndihmën në mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe veprave tjera të ngjashme. Kjo rregullore ka shërbyer për periudhën kur Kosova nuk e kishte Kodin Penal dhe u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës me datën 6 prill 2004 (UNMIK Rregulation 2003/5), ku trafikimi me njerëz është përfshirë si vepër penale me nenin 139 të këtij kodi.

2002

Themelimi i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV)

Divizioni për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave u themelua në vitin 2002 në kuadër të Departamentit të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë. Stafi përfshinte Mbrojtësit e Viktimave, me profesion jurist dhe sociolog, të cilët u trajnuan kryesisht në fushën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njëriç dhe më pastaj e zgjeruan asistencën e tyre edhe ndaj viktimave të dhunës në familje dhe abuzimit seksual. Në atë kohë (sipas Rregullores se UNMIK-ut 2001/4) mandati i Mbrojtësve të Viktimave ishte që viktimave t'i ofrojnë udhëzime, këshilla dhe mbështetje në sistemin e drejtësisë duke i shoqëruar ato në gjykatë, në strehimore, qendra shëndetësore dhe shërbime tjera sociale. Në vitin 2011, kjo zyre transferohet nën Zyren e Kryeprokurorit të Shtetit, dhe poashtu ndryshon dhe fuqizohet roli i Mbrojtësit të Viktimave në sistemin e Drejtësisë. Do të shihni më poshtë me kalimin e kohës rolin e zgjeruar dhe të fuqizuar të Mbrojtësve të viktimave.

2003

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/12 për mbrojtjen nga dhuna në familje

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/12 për mbrojtjen nga dhuna në familje hyri në fuqi me 7 maj 2003 dhe paraqiste bazën e parë ligjore, respektivisht ligjin e veçantë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në Kosovë. Rregullorja përcaktonte procedurën civile sipas së cilës viktimat e dhunës në familje mund të kërkojnë urdhër mbrojtje nga kryesi i dhunës në familje. Rregullorja poashtu kërkonte ndjekjen automatike të shklejes së urdhrit për mbrojtje. Megjithatë, gjykatat kanë dështuar në zbatimin e kësaj rregulloreje duke mos i gjykuar kërkesat për udhër mbrojtje brenda afatit ligjor; duke luajtur rolin e ndërmjetësuesit për të unifikuar viktimën dhe kryesin dhe duke dështuar në ndjekjen penale në rastet e shklejes së urdhërit e të tjera. Mungesat e tilla në zbatimin e rregullores kanë çuar në hartimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për të fuqizuar implementimin e tij nga gjykatat.

2004

Hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) kundër Trafikimit me genie njerëzore

Organizatata ndërkombëtare dhe lokale të Kosovës që punojnë në fushën e ofrimit të ndihmës dhe mbrojtjes ndaj viktimave të trafikimit me njerëz, hartuan Procedurat Standarde të Veprimit kundër Trafikimit me njerëz në vitin 2004. Ky dokument synonte t'i bashkërendojë aktivitetet e secilit institucion që ka kontakt me viktimën dhe ka për obligim t'i ofrojë ndihmën dhe mbrojtjen për viktimë. Ky dokument poashtu përcaktonte specifikisht përgjegjësitë e secilit institucion duke filluar nga policia, mbrojtësit e viktimave, qendrat për punë sociale, strehimoret, qendrat mjekësore, prokuroritë dhe gjykatat. PSV-të janë rishikuar përsëri në vitin 2013 me qëllim të përmirësimit të koordinimit institucioinal.

2005

Urdhërresa administrative nr.2005/3 për zbatimin e rregullores së UNMIKU-ut nr.2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë

Kjo urdhërrësë e cila ka derivuar nga rregullorja e UNMIK-ut për ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, kishte për qëllim të qartësojë rolin dhe përgjegjësinë e Koordinatorit të ndihmës së viktimës, të themelimit të fondit për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit, krijimit të një komisioni për rishikim për kumtimin e vendimeve të koordinatorit për ndihmë viktimave dhe dhënies së ndihmës shtesë për viktimat e trafikimit dhe dëshmitarëve jashtë Kosovës. Ky Koordinator ishte menduar të jetë pjesë e Divizionit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave e vendosur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në atë kohë. Kjo urdhërrësë nuk gjeti zbatim asnjehërë dhe rrjedhimisht nuk u formua koordinatori apo fondi i kompensimit për viktimat e trafikimit siç ishte paraparë me këtë legjislacion sekondar. Megjithatë, kjo urdhërrësë krijoi një bazë për hartimin e legjislacionit specifik për kompensimin e viktimave shumë vite më vonë.

2008

Themeli i Koalicionit të Strehimoreve të Kosovës i përbërë nga 8 organizata joqeveritare që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat e krimit

Strehimoret e Kosovës vendosin të formojnë koalicionin e tyre në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre dhe të punojnë së bashku në përmirësimin e ndihmës për viktimat e kategorive të dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së këtyre qendrave. Koalicioni hartoi vizionin, misionin, standardet për funksionimin e strehimoreve dhe planin strategjik për vitin 2008-2011. Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës përbëhet nga 8 strehimore siç janë: Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë, Shtëpia e sigurtë në Gjakovë, Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fëmijëve-Liria në Gjilan, Qendra për Mirëqenien e gruas në Pejë, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Njerëz në Prishtinë; Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve në Prishtinë, Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren dhe Qendra për mbrojtjen e gruas në Mitrovicë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi më 15 qershor 2008, disa muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kushtetuta është akti më i lartë juridik cili i mbron të drejtat e qytetarëve të këtij vendi. Kushtetuta e Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit dhe poashtu siguron edhe barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e shoqërisë. Të drejtat dhe liritë e njeriut të grantuara me marrveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare garantohen me këtë Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike, siç janë: Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokolet e saj; Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas; Konventa për të drejtat e fëmijës etj.

Themelimi i Koordinatorit Nacional kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme

Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore u themelua në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe i cili emërohet nga Qeveria. Koordinatori Nacional e kryeson dhe bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar, gjegjësisht grupin ndërministror i përbërë nga institucionet kompetente për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave. Koordinatori është përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të mekanizmit kombëtar të referimit për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz.

2009

Themelimi i Departamentit të Mjekësisë Ligjore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë

Departamenti i Mjekësisë Ligjore e cila gjendet në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është përgjegjës për kryerjen e ekzaminimeve klinike të viktimave, dëshmitareve dhe të dyshuarve për vepra penale kundër integritetit seksual të personave. Në bazë të urdhërresës nga organet e hetuesisë dhe gjyqësisë së vendit, ky Departament mund të bëjë ekzaminimin e viktimës dhe të sigurojë prova për formën e dhunës së ushtruar ndaj viktimës.

TIP raporti për Departamentin e Shtetit Amerikan

Kosova që nga viti 2009 për çdo vit raporton për Raportin për Trafikimin e Njerëzve (Trafficking in Persons Report), i cili është instrumenti kryesor diplomatik i qeverisë së SHBA-së për të angazhuar qeveritë e huaja kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ky raport është gjithashtu burimi më i plotë i përpjekjeve qeveritare kundër trafikimit dhe pasqyron angazhimin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara për udhëheqjen globale në këtë çështje kryesore të të drejtave të njeriut dhe të zbatimit të ligjit. Qeveria e SHBA përdor Raportin e TIP për të angazhuar qeveritë e huaja në dialogje për të avancuar reformat kundër trafikimit dhe për të luftuar trafikimin dhe për të synuar burimet për parandalimin, mbrojtjen dhe programet e ndjekjes

penale. Në Raportin e TIP, Departamenti i Shtetit i vendos çdo vendi në një nga tre nivelet bazuar në shkallën e përpjekjeve të qeverive të tyre për të përmbushur standardet minimale për eliminimin e trafikimit. Përderisa Tier 1 është renditja më e lartë, kjo nuk do të thotë se një vend nuk ka problem të trafikimit me njerëz. Përkundrazi, një renditje sipas nivelit të parë tregon se një qeveri ka pranuar ekzistencën e trafikimit me njerëz dhe ka bërë përpjekje për të adresuar problemin. Çdo vit, qeveritë duhet të demonstrojnë përparim të dukshëm në luftën kundër trafikimit për të mbajtur një renditje të grupit të parë. Vitin e kaluar, Kosova është renditur në *Grupin Tier 2* dhe ndër problematikat e listuara kanë qenë dështimi në identifikimin e viktimave të trafikimit dhe dështimi në ndjekjen penale të rasteve të trafikimit me njerëz. Rekomandimet nga TIP raporti kanë qenë të drejtuara kah trajnimi dhe specializimi i prokurorëve, hetimi dhe ndjekja penale e rasteve të trafikimit, ndëshkimi i trafikantëve dhe shqiptimi i dënimeve më të larta dhe veçanërisht njëkësia e zyrtarëve publik të përfshirë në veprat e trafikimit me njerëz.

2010

Rifunksionalizmi i Linjes Ndhmëse falas 0800 11 112

Linja ndihmëse falas është numër pa pagesë në kuadër të Zyres për Mbrojtje dhe Ndhmë Viktimave. Kjo linjë ndihmëse është themeluar me qëllim të informimit dhe raportimit të viktimave të trafikimit me njerëz dhe pas një periudhe të mosfunksionimit është revitalizuar përsëri në vitin 2010. Linja ndihmëse falas tash e tutje ofron mundësinë për qytetaret dhe viktimat të raportojnë krimet siç janë trafikimi, dhuna në familje, abuzimi seksual dhe të marrin informata, këshilla dhe udhëzime për referim tek institucionet tjera përgjegjëse. Informatat që jepen në këtë linjë janë konfidenciale.

Standardet Minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore

Standardet Minimale të kujdesit ndaj viktimave të trafikimit me njerëz është dokument që përcakton standardet minimale të kujdesit që nga faza e identifikimit të viktimës deri te reintegrimi i plotë i saj. Çdo ofruer i shërbimeve për viktimat e trafikimit me njerëz është i obliguar t'i përmbahet standardeve dhe procedurave të paraqitura në këtë dokument, në mënyrë që të sigurohet ofrimi i shërbimeve cilësore dhe efikase për viktimat. Ky dokument është hartuar nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave jo-qeveritare të Kosovës të cilët ofrojnë shërbime dirkete për viktimat e trafikimit me njerëz.

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nr.03/L-182 ka hyrë në fuqi me 15 korrik 2010 dhe e ka shfuqizuar rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/12 për mbrojtje nga dhunë në familje. Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje është ligj specifik që ka për qëllim parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje. Ligji definon dhunën familjare dhe marrëdhënien familjare , poashtu edhe parasheh masa mbrojtëse të cilat mund t'i kërkojë viktimë në gjykatën civile. Urdhërat për mbrojtje janë të 3 llojeve: urdhri mbrojtës për të cilën gjykata vendos pas 15 ditëve, urdhri mbrojtës emergjent për të cilën gjykata vendos brenda 24 orëve dhe urdhri i përkohshëm emergjent që mund të lëshohet nga policia në orët kur gjykata nuk punon apo gjatë vikendeve. Disa prej masave mbrojtëse që mund të shqiptohen janë si psh. ndalimi i afrimit viktimës, ndalimi i shqetësimit të viktimës, largimi nga hapësira e banimit, shoqërimi i viktimës nga policia për marrjen e gjësendeve personale, trajtimi psikosocial dhe trajtimi nga varësia e kryesit nga droga dhe alkooli. Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje përcakton përgjegjësitë e Policisë së Kosovës në zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Shkelja e urdhrit për mbrojtje paraqet vepër penale dhe duhet të ndiqet nga gjykata penale. Më vonë janë nxjerrur dy udhëzime administrative të cilat kanë synuar që të fuqizojnë implementimin e masave të parapara në Ligj sa i përket trajtimit të kryesit, duke sqaruar mënyrën dhe vendin e trajtimit psikosocial dhe trajtimit të obligueshëm nga varësia nga droga dhe alkooli, por të cilat asnjëherë nuk gjetën zbatim në praktikë.

2011

Programi për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014

Programi për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, përcakton prioritetet e institucioneve vendore dhe Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen dhe sigurinë, përkrahje, trajtimin dhe reintegrimimin e viktimave të dhunës në familje. Plani i Veprimit përcaton objektivat dhe aktivitete specifike të institucioneve përgjegjëse në secilën prej shtyllave të programit të përmendura më lartë. Ndër aktivitet kryesore të parapara me këtë program ishte hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit kundër Dhunës në Familje dhe themelimi i Koordinatorit Nacional.

Themeli i Javës për të drejtat e viktimave të krimit- Zyra e Kryeprokurorit i Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit pas një vizite në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 2010 filloi të organizojë “Javën për të Drejtat e Viktimave të Krimit” me qëllim të vetëdijësimit të opinionit të gjerë lidhur me të drejtat e viktimave të krimit dhe ndihmën që i ofrohen këtyre viktimave në sistemin e drejtësisë. Java për të drejtat e viktimave tashmë është bërë traditë e Zyres së Kryeprokurorit dhe organizohet çdo vit gjatë muajit tetor, ku e gjithë java mbulohet me aktivitete të ndryshme vetëdijësuese

nga prokurorët, gjyqtarët dhe mbrojtësit e viktimave. Gjatë kësaj jave organizohen konferenca, tryeza diskutimi, shtypja e materialeve vetëdijësuese dhe ligjerata në shkolla dhe universitete me qëllim të vetëdijësimit të audiencave të ndryshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit në Kosovë. Njëra nga temat dhe mesazhet e javës e cila vlen për çdo vit është “ *1 javë vetëdijësim, 365 ditë shërbim*”, i cili mesazh ka për synim që të theksojë obligimin e institucioneve në shërbimin ndaj viktimave të krimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre në çdo kohë dhe çdo ditë.

Transferimi i ZMNV në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Në vitin 2011, Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave transferohet në Zyren e Kryeprokurorit të Shtetit, rrjedhimisht edhe zgjerohet dhe fuqizohet roli i Mbrojtësit të Viktimave edhe në pajtim me ndryshimin e kodit penal dhe kodit të procedurës penale në vitin 2013. Mbrojtësit e Viktimave, tani janë të obliguar të jenë jurist të diplomuar dhe veprojnë si përfaqësues i autorizuar i viktimës dhe e përfaqësojnë viktimën në polici, prokurori dhe gjykatë dhe janë persona kyç për viktimën qoftë në procedurat civile ashtu edhe në penale. Mbrojtësi i Viktimave ka kompetencë për të njoftuar viktimën për të drejtat e saj; të përfaqësojë interesat e viktimës në prokurori dhe gjykatë. Mbrojtësi i viktimave vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme dhe e duhur për ta ndaluar shkeljen e të drejtave të viktimës dhe për të kërkuar veprim për garantimin e mbrojtjes së tyre. Mbrojtësit e Viktimave ndërtojnë një raport të veçantë me viktimën dhe rrjedhimisht viktimat kanë

mbështetjen maksimale morale dhe profesionale para, gjatë dhe pas procesit gjyqësor. Mbrojtësi i Viktimave është urëlidhës mes viktimës dhe prokurorit dhe ka rol kyç gjatë hetimit, ndjekjes dhe shqyrtimit të rastit në gjykatë. Ndërsa, në procedurën civile, gjegjësisht në kërkesat për urdhër mbrojtje roli i tyre është edhe më specifik ku i asistojnë viktimat në dorëzimin e kërkesës për urdhër mbrojtje, komunikojnë me gjyqtarin civil dhe përfaqësojnë viktimën gjatë seancës për vërtetimin dhe shqiptimin e urdhrit për mbrojtje. Mbrojtësit e viktimave janë të vendosur në 7 regjionet e Kosovës në kuadër të Prokurorive Themelore.

Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me njerëz dhe Plani i Veprimit 2011-2014

Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz 2001-2014 u hartua nga grupi ndërministror në kuadër të Koordinatorit Nacional dhe është një dokument strategjik i cili përcakton politikat dhe masat që duhen ndërmarr dhe fuqizimin e institucioneve për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz. Ky dokument rrjedh nga prioritetet e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar, dhe paraqet qëllimet strategjike dhe objektivat specifike për arritjen e tyre. Objektivat e Strategjisë dhe Plani i Veprimit janë rishikuar në vitin 2015 dhe është hartuar Strategjia e re kundër trafikimit.

2012

Ligji i Kosovës për Ndihmë Juridike falas

Ligji për ndihmë juridike falas i ka përfshirë edhe viktimat e dhunës në familje në kategorinë e personave që kanë të drejtë të nisnin procedura për të kërkuar ndihmë juridike falas. Agjencioni për ndihmë juridike falas përmes zyreve rajonale për ndihmë juridike falas tashmë ofrojnë informata, këshilla dhe përfaqësim ligjor për viktimat e dhunës në familje kryesisht në gjykatën civile kur ka të bëjë me kujdestari të fëmijëve dhe shkurorëzime. Mungesat në resurset njerëzore të këtij institucioni e vështorëson përfaqësimin ligjor të viktimave në procedurat penale gjyqësore.

2013

Riskstrukturimi i ZMNV dhe Procedurat Standarde të Veprimit të aprovuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Në vitin 2013, ZMNV harton rregulloren e zyres që e përcakton mandatin, funksionimin dhe strukturën e ZMNV dhe Procedurat Standarde të veprimit ku përcakton hapat që i ndërmerr Mbrojtësi i viktimave gjatë kontaktit të parë me viktimën, ofrimit të mbështetjes, hetimit të rastit dhe përfaqësimit në polici, prokurori dhe gjykata. Përmes këtyre PSV-ve Mbrojtësve të Viktimave i përcaktohen kategoritë e viktimave të cilat do të asistohen: viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit me njerëz, viktimat e abuzimit seksual, grabitje dhe vrasje. Roli i Mbrojtësit të Viktimave është shumë crucial në mbrojtjen e viktimave të krimit (shih pjesën për mbrojtësit e viktimave të përshkruar më lartë).

Themelimi i Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë

Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje e themeluar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2013 dhe është organ përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të para me Programin e Dhunës në Familje. Zyra e Koordinatorit Nacional poashtu e udhëheq grupin ndërministror kundër dhunës në familje e përbërë

nga përfaqësues të ministrive të ndryshme që janë përgjegjës për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Koordinatori Nacional emërohet me vendimin e Qeverisë dhe zakonisht është post politik, pra zakonisht caktohet njëri nga Zëvendës Ministrat e Ministrisë së Drejtësisë.

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhunën në Familje

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje janë hartuar bazuar në Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014. Ky dokument u hartua nën autoritetin e Koordinatorit Kombëtar dhe udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore, dhe institucionet tjera vendore që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Qëllimi i këtyre PSV është krijimi i një sistemi të koordinuar të institucioneve të Kosovës, të cilat reagojnë në formë të menjëhershme dhe të vazhdueshme në rastet e dhunës në familje me qëllim të ofrimit të ndihmës cilësore dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Me zbatimin e PSV-ve mekanizmat institucional shtetëror dhe partnerë tjerë do të harmonizojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin në fazat e identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegritit të viktimave të dhunës në familje dhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje.

Rishikimi i Procedurave Standarde të Veprimit për Trafikimin me Qenie Njerëzore

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Trafikimin me Qenie Njerëzore u rishikuan në vitin 2013, me qëllim të përmirësimit dhe harmonizimit të veprimeve të institucioneve që ofrojnë mbështetje dhe mbrojtje viktimave të rritur dhe viktimave fëmijë të trafikimit me njerëz në të gjitha nivelet e referimit të tyre përfshirë procesin e referimit fillestar, identifikimin e hershëm dhe formal, periudhës së reflektimit, ndihmës së parë dhe të mëtutjeshme, mbrojtjes, riintegritimit dhe përfshirjes sociale, kthimit apo vendosjes së asistuar, procedurave civile dhe penale. Këto PSV janë munduar të mbulojnë hapësirat eidentifikuara mes teorisë dhe praktikës duke siguruar procedura konsistente të detajuara të bazuara në menaxhimin e rastit dhe qasjes multi-institucionale dhe multi-diciplimore për të siguruar mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimave të trafikimit me njerëz qofshin ato viktimave vendore apo të huaja.

Udhërrëfyes mbi dhunën bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore

Ky udhëzues është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe i dedikohet ofruesve të shërbimeve shëndetësore në institucionet e nivelit parësor, dytësor dhe tretësor për ofrimin e kujdesit gjithpërfshirës dhe efektiv për të mbijetuarat e dhunës së bazuar në gjini, veçanërisht të viktimave të dhunës në familje dhe abuzimit seksual. Udhëzuesi ofron shpjegime për aspektet mjekësore të problematikës së dhunës në baza gjinore përfshirë edhe kujdesin psiko-social si dhe mënyrën e referimit

në organet e zbatimit të ligjit, organet e drejtësisë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve.

Kodi i Procedurës Penale dhe roli i viktimës dhe mbrojtësit të viktimave

Kodi i Procedurës Penale 2013 ka paraparë dispozitat specifike që i japin rol të rëndësishëm viktimës në procedurën penale dhe ofrojnë të drejta të përcaktuara për viktimën/të dëmtuarin. Gjatë procedurës penal, viktimia/i dëmtuari ka të drejta të përcaktuara sipas nenit 62 dhe sipas nenit 63 ku viktimia mund të përfaqësohet nga anëtari i Odës së Avokatëve, Mbrojtësi i Viktimave ai nga vet viktimia. Me heqjen e padisë supsidiare dhe ato private nga kodi, i dëmtuari/viktimia ka rol të madh në procedurë gjatë fazës së mbledhjes së provave edhe gjatë shqyrtimit. Neni 218 “Deklarimi i dëmit nga i dëmtuari”, mundëson viktimës që të paraqes deklarinimin e dëmit në rastet kur viktimia ka pësuar dëm material, fizik dhe emocional të shkaktuar nga vepra penale. Sipas nenit 217, viktimia mund të kërkojë nga prokurori që të mbledh prova, qoftë brenda apo jashtë Kosovës. Nëse i pandehuri negocion marrëveshjen për pranimin e fajësisë, gjykata para pranimit të marrëvedhjes e pyet viktimën për mendimin e saj nga neni 233 dhe poashtu mund të kërkojë kompensim nga i pandehuri. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, viktimia mund të parashtrijë pyetje, të paraqesë prova dhe të paraqet edhe fjalën hyrëse dhe fjalën përfundimtare. Për më tepër, gjatë tërë këtyre proceseve, Mbrojtësi i Viktimave është i obliguar të informojë viktimën për të drejtat e saj dhe të bashkëpunojë me Prokurorin për të shërbyer si urëlidhës në mes prokurorit dhe viktimës dhe të jetë aty për viktimën

tërë kohën. Një rol i tillë më aktiv për viktimën në procedurë e vendos atë në qendër të vëmendjes dhe dukshëm fuqizon të drejtat e viktimave.

Kodi i Procedurës Penale vendos poashtu bazën për krijimin e Fondit për kompensimin e viktimave (neni 19, paragrafi 1.28), tek i cili fond referohet edhe në nenin 62 Të drejtat e të dëmtuarit/viktimës, ku i jepet e drejta viktimës që të kërkojë kompensim nga fondi i kompensimit në rastet kur nuk mund ta realizojë dëmshpërblimin nga i pandehuri.

Kodi Penal i Kosovës- bazat për dëmshpërblimin dhe kompensimin e viktimës

Kodi Penal i Kosovës (2013) poashtu ka qasje të qendërsuar ndaj viktimës dhe i mbron të drejtat e viktimave përmes shumë dispozitave përgjatë kodit, duke filluar prej nenit 41- qëllimi i dënimit që liston kompensimin e viktimave për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale. Neni 62 dënimet plotësuese përfshirë poashtu urdhrin për kompensimin e humbjes apo dëmit. Neni 64 urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, poashtu obligon gjykatën që të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale për vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë apo edhe humbjen e të ardhurave të cilat viktimat i ka përjetuar si rezultat i veprës penale.

Neni 74 i Kodit Penal parasheh që vepra penale kundër viktimës së ndjeshme është rrethanë rrënduese që merret parasysh gjatë caktimit të dënimit. Në përkufizimin e viktimës së

ndjeshme janë përfshirë fëmija, gruaja shtatëzanë ose partneri familjar (neni 12). Kodi penal poashtu përkufizon marrëdhënien familjare ndërmjet dy personave. Përveç zbatimit të rrethanave rrënduese, të cilat vlejnë për cilëndo vepër penale të kryer kundër marrëdhënies familjare, Kodi Penal i numëron disa vepra penale me dispozita të ndërlidhura kur vepra është kryer kundër viktimës së ndjeshme, që gjithashtu përfshijnë viktimën nga marrëdhënia familjare. Dispozitat e ndërlidhura të caktimit të dënimit demostrojnë seriozitet të shtuar nëse vepra penale është kryer kundër partnerit familjar.

Ligji për Luftimin e trafikimit me njerëz

Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtje e viktimave të trafikimit nr.04/L-218 hyri në fuqi në gusht të vitit 2013. Hartimi i ligjit u kryesua nga Koordinatori Nacional dhe grupi ndër-ministror së bashku me organizata ndërkombëtare të cilët e asistuan procesin përmes ekspertizës dhe mbështetjes financiare. Ky është ligj specifik ku përcaktohen autoritetet kompetente të cilët kanë të drejtën dhe përgjegjësinë për parandalimin, identifikimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij; ndjekjen penale të trafikimit me njerëz; mbrojtjen e viktimave të trafikimit duke ofruar mbështetje psiko-sociale, kompensim, ndihmë ligjore dhe të drejta tjera. Ligji poashtu i obligon misionet diplomatike dhe zyret konsullore në Republikën e Kosovës që të zbatojnë ligjin, të ofrojnë ndihmë viktimave dhe të bashkëpunojnë në rastet e riatdhesimit të viktimave të trafikimit. Ligji është hartuar në përputhje me të gjitha instrumentet dhe konventat europiane për luftimin e trafikimit me njerëz.

Ligji për Shëndetësi i Republikës së Kosovës nr.04/L125

Me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, këto kategori të viktimave janë përfshirë në Ligjin për Shëndetësinë e Kosovës. Sipas nenit 61 këtij ligji viktimat e trafikimit me njerëz dhe viktimave të dhunës në famije hyjnë në kategorinë e qytetarëve të liruar nga pagesat për shërbime mjekësore. Viktimat e referuara në institucione shëndetësore shtetërore do të marrin shërbime mjekësore falas dhe kjo është një hap shumë i rëndësishëm në përmirësimin e mirëqenies së viktimave të këtyre kategorive.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për dështimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës për të shqyrtuar kërkesën për urdhër mbrojtje të viktimës Diana Kastrati dhe shkeljen e së drejtës për jetë të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Me 18 maj 2011, Diana Kastrati, nënë e një fëmije, ishte vrarë nga ish-bashkëshorti Adnan Jashari në afërsi të shtëpisë së saj në qendër të Prishtinës. Diana Kastrati tri javë më parë kishte dorëzuar kërkesë për urdhër mbrojtje emergjente nga Gjykata Komunale e Prishtinës të asaj kohe, e cila kërkesë nuk ishte shqyrtuar asnjëherë. Protesta të shumta u organizuan nga organizata të ndryshme dhe familja e Dianës, duke fajësuar gjykatën për dështimin e ofrimit të ndihmës dhe mungesës së llogaridhënies nga organet e drejtësisë. Këto protesta kishin edhe për qëllim të tërheqin vëmendjen e gjyqësorit për trajtimin më adekuat dhe me prioritet të rasteve të dhunës në familje. Në vitin 2012, prindërit e së ndjerës, z.Gëzim Kastrati dhe znj.

Makfire Kastrati kanë paditur Gjykatën Komunale në Prishtinë i cili nuk ka vepruar sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, për shkelje të së drejtës për jetë të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës së Kosovës, me nenin 3 të Deklartës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), që ka qenë si pasojë e mosveprimit të Gjykatës, duke mos e shqyrtuar kërkesën për urdhrin për mbrojtje nga viktimat. Ata kishin shterur të gjitha mjetet ekzistuese juridike në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe kjo ishte mundësia e fundit për të kërkuar të drejtën e tyre. Parashtruesit e kërkesës kishin pohuar se Gjykata Kushtetuese duhet të adresojë këtë çështje me qëllim të parandalimit të rasteve të njëjta tragjike në të ardhmen, si dhe me qëllim të vetëdijësimit të opinionit publik për urgjencën e funksionalizimit të gjykatave të rregullta. Gjykata Komunale e Prishtinës ka pasur obligim të veprojë brenda 24 orësh nga momenti i parashtrimit të kërkesës për urdhrin mbrojtje emergjente nga viktimat D.K., përderisa gjykata nuk kishte vepruar fare në këtë rast. Në vitin 2013, Gjykata Kushtetuese bëri publike vendimin dhe konstatoi se ka pasur shkelje të së drejtës për jetë dhe se ka pasur shkelje të së drejtës për mjete juridike sipas Kushtetutës së Kosovës dhe KEDNJ-së.

Ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese edhe pse nuk e kthente në jetë Dianën, kishte rëndësi të veçantë për prindërit e saj dhe njëkohësisht edhe për institucionet e vendit të cilëve iu përkujton se janë përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit dhe parandalimin e shkeljeve të të drejtave të tyre në të ardhmen. Ky ishte rasti i parë kur shteti mbahet përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut.

Vrasësi i Diana Kastratit asnjëherë nuk u kap nga policia dhe vazhdon ende edhe çështja e vajzës së saj, e cila është lënë në kujdestari të prindërve të vrasësit.

Themelimi i Forumit të Gjyqtareve dhe Prokuroreve të Kosovës

Forumi i grave gjyqtare dhe prokurore të Kosovës u themelua në mars të vitit 2013, që shënohet si muaji ndërkombëtar i gruas dhe i dedikohet sensibilizimit për të drejtat e grave dhe kontributin e grave përgjatë historisë dhe në fusha të ndryshme të shoqërisë. Themelimi i Forumit ishte iniciuar dhe mbështetur nga Departamenti i Drejtësisë së Ambasadës Amerikane, ku gjyqtaret dhe prokuroret gra u mbledhën për të punuar rreth një qëllimi të përbashkët që është fuqizimi i pranisë së femrave në sistemin e drejtësisë. Forumi punon për të krijuar një ambient ku femrat do të kenë mundësinë dhe mbështetjen për ndryshim përmes pjesëmarrjes aktive dhe përmirësim të pozitës së gjyqtareve dhe prokuroreve. Forumi ka qenë mjaftë aktiv përgjatë viteve të fundit, ku vlen të theksohet puna në hartimin e doracakut për gjyqtarë dhe prokurorë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe organizimi i Konferencës rajonale në maj të vitit 2017, ku morën pjesë gjyqtare dhe prokurore nga shtet si Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia dhe Rumania.

Themelimi i Bordit këshilldhënës dhe koordinues për të drejtat e komunitetit Lesbik, gej, biseksual dhe transgjijor (LGBT) në kuadër të Zyrës për Qeverisje të mirë-Zyra e Kryeministrit të Kosovës

Qeveria e Kosovës e formoi Grupin Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT që shërben si mekanizëm kryesor këshillëdhënës dhe koordinues për institucionet e Kosovës që kanë si qëllim mbrojtjen dhe promovimin a të drejtave të komunitetit LGBT. Grupi është i përbërë nga një numër i madh i përfaqësuesve nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare. Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e këtij bordi përfshijnë por nuk kufizohen në: ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve për institucionet qendrore dhe lokale për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT ; këshillon institucionet në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes lidhur me procesin e zbatimit të politikave, programeve dhe masave të tjera të aprovuara nga Qeveria e të cilat i referohen të drejtave të komunitetit LGBT; këshillon dhe ndihmon procesin e zhvillimit dhe zbatimit të fushatave të informimit publik dhe të projekteve tjera promovuese për të rritur ndërgjegjësimin e zyrtarëve dhe opinionit publik mbi standardet e të drejtave të komunitetit LGBT etj. Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit monitoron dhe raporton lidhur me procesin e zbatimit e rekomandimeve të cilat Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT i adreson tek institucionet në nivel qendror dhe lokal.

Licencimi i subjekteve juridike/ organizatave që ofrojnë shërbime sociale, respektivisht shërbime direkte për viktimat e dhunës në famije dhe trafikimit

Udhëzimi Administrativ nr.17/2013 për licencimin e subjekteve juridike/organizatave që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare u hartua nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies (MPMS) me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore e teknike dhe krijimit të ambientit konform standardeve të përcaktuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga ana e subjekteve juridike/organizatave lidhur me licencim. Udhëzimi përcakton procedurat, kushtet dhe kriteret që duhet t'i plotësojnë subjektet juridike/organizatat në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Ky udhëzim ka rëndësi të madhe, ngase i obligon të gjitha subjektet/organizatat që ofrojnë shërbime për viktimat të aplikojnë për licencim dhe rrjedhimisht edhe të plotësojnë kushtet dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve të tilla për këtë kategori të ndjeshme. Të gjitha strehimoret dhe stafi i tyre janë detyruar të kalojnë nga procesi i licencimit, si kusht për të pasur pastaj të drejtën për të ofruar shërbime dhe për të pasur të drejtën për të aplikuar në grantet për strehimore që jepen nga MPMS.

2014

Implementimi i formave standarde për parashtrimin e kërkesës për urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës në familje

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF) nr.03/L-182 i mundëson viktimave të dhunës në familje që të parashtrorjnë kërkesë për urdhër për mbrojtje. Urdhurat mbrojtës dhe urdhrat për mbrojtje emergjente lëshohen në gjykata civile dhe sigurojnë masa mbrojtëse për viktimën. Në parashtrimin e kërkesës për urdhër mbrojtje, viktimat mund të kërkojnë ndihmën e Mbrojtësit të Viktimave, Qendrës për Punë Sociale, Zyrave për Ndihmë Juridike dhe OJQ-ve tjera që ofrojnë shërbime të tilla. Edhe pse Ligji aktual jep përshkrime lidhur me përbajtjen e një kërkesë për urdhër mbrojtje, është vërejtur mungesa e uniformitetit të kërkesave të parashtruara nga viktimat apo ndonjëri nga akterët e përmendur më lartë. Në fillim Mbrojtësit e Viktimave i ndihmonin viktimat në parashtrimin e kërkesës për urdhër mbrojtje duke përdorur një formë të thjeshtë me shkrim ku përshkruajnë rastin e dhunës në familje dhe zakonisht duke kërkuar caktimin e një mase mbrojtëse. Pastaj u hartua formulari i standardizuar i kërkesës për urdhër mbrojtje që ofron një përdorim më praktik të tij. Pasi që formulari në vete përmban të gjitha masat mbrojtëse të përcaktuara me LMDHF, është shumë më lehtë për viktimën (ose për të tjerët që kërkojnë në emër të viktimës) të i njeh masat mbrojtëse të mundshme. Formularët siguruan një përdorim uniform në tërë Kosovën dhe ofruan më shumë informata gjyqtarit duke iu lehtësuar punën e tyre.

Formularët e standardizuar iu vënë në dispozicion viktimave, gjykatës dhe zyreve të mbrojtësve të viktimave.

Themelimi i strehimores së parë për viktimat e dhunës në familje në Ferizaj

Në vitin 2014 u hap strehimorja e parë në qytetin e Ferizajit që strehon viktimat e dhunës në familje dhe ato të trafikimit me njerëz. Ferizaji ishte i vetmi qytet në Kosovë që nuk kishte strehimore të sigurtë për viktimat dhe viktimat e këtij regjionin përcjelleshin në strehimoret e regjioneve tjera. Organizata joqeveritare e cila e mori përsipër menaxhimin e kësaj strehimoreje gjeti mbështetjen e Komunës së Ferizajit dhe poashtu edhe Ambasadës Amerikane në Prishtinë për të filluar punën me asistimin e viktimave të dhunës në familje. Më vonë strehimorja dhe stafi i saj u licencua për ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe fitoi edhe grantin për strehimore nga Ministria e Punës dhe Mirëqenia Sociale. Tani strehimorja ofron strehim për 24/7, kryesisht për viktimat e dhunës në familje.

Hartimi dhe implementimi i formës standarde për deklaratën e dëmit në procedurë penale

Kodi i ri i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ka paraparë dëshmipërblimin e viktimave (palës së dëmtuar) në procedurë civile dhe penale. Me qëllim të zbatimit të nenit 218 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, neni 218 “Deklarimi i dëmit nga i dëmtuari” dhe lehtësimit të procedurës për deklarinin e dëmit nga ana e viktimës në rastet kur viktimat ka pësuar dëm material, fizik dhe emocional të shkakuar

nga vepra penale, është vënë në përdorim një formular i unifikuar i deklaratës së dëmit. Ky formular shërben si mjet për viktimën që të paraqes ndikimin që ka pasur vepra penale në viktimën dhe gjithashtu mund të shërbejë si kërkesë pasurore nëse ajo përmban informacionin e nevojshëm mbi ndikimin financiar dhe shpenzimet e shkaktuara. Formulari standard për deklaratën mbi dëmin është hartuar në përputhje me kërkesat nga neni 218. Formulari iu është vënë në dispozicion policisë, prokurorëve, mbrojtësve të viktimave dhe gjykatësve. Secili duhet të sigurojë që viktima është informuar në lidhje me mundësinë për të paraqitur deklaratën mbi dëmin në mënyrë që të konsiderohet nga gjykata si palë në procedurën penale dhe se viktima/pala e dëmtuar ka qasje në këtë formë standarde. Viktima kryesisht është ndihmuar nga Mbrojtësi i Viktimave për ta plotësuar deklaratën mbi dëmin e cila pastaj iu dorëzohet prokurori si pjesë e lëndës. Fatkeqësisht adresimi i dëmshpërblimit në procedurën penale është shumë i pakët dhe pothuajse asnjë viktimë nuk arrin të dëmshpërblehet nga i pandehuri, edhe pse e kërkon atë duke plotësuar deklaratën e dëmit.

Caktimi i Prokurorëve dhe Gjyqtarëve Koordinator të Dhunës në Familje

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës caktuan prokurorë dhe gjyqtarë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Nga një prokurorë nga secila Prokurori themelore në Kosovë u caktua si Koordinator i rasteve të dhunës në familje. Këta prokurorë nuk trajtonin vetëm rastet e dhunës në familje por merreshin edhe me raste të tjera, ose i delegonin

rastet e dhunës në familje tek prokurorët tjerë. Pra, operonin vetëm si koordinatorë të rasteve të dhunës në familje dhe pikë kontakti për policinë, gjykatën dhe institucionet tjera në rastet e dhunës në familje. Përderisa, nga një gjyqtarë civil ishin caktuar në Gjykatat Themelore të Kosovës të cilët ekskluzivisht merreshin vetëm me rastet e dhunës në familje, gjegjësisht në shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrave mbrojtës për mbrojtjen nga dhuna në familje. Caktimi i gjyqtarëve për dhunë në familje ka rezultuar të jetë shumë efikase ngase ndihmojnë në shqyrtimin më të shpejtë të kërkesave për urdhër mbrojtje. Pasi caktimi i koordinatorëve nga ana e prokurorisë nuk u tregua edhe aq efikase, rishtazi janë hartuar Procedurat Standarde të Veprimit për zyrtarizimin dhe caktimin e prokurorëve që ekskluzivisht do t'i trajtojnë rastet e dhunës në familje.

Komentari i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Komentari i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje u lansua nga Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës me qëllim të zbatimit të mirëfilltë të Ligjit, nxjerrjen e kuptimit të drejtë të tij, interpretimit të drejtë të dispozitave ligjore dhe përbajtjes së tyre. Komentari jep udhëzime se si çdo dispozitë duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të sigurohet mbrojtje më e mirë për viktimat e dhunës në familje. Qëllimi i hartimit të komentarit është paoshtu sqarimi i dilemave që ka pasur në implementimin e dispozitave të ligjit në mënyrë që të lehtësojë punën e profesionistëve që e zbatojnë atë në baza ditore gjatë punës së tyre.

Udhëzimi administrativ nr.01/2014 për identifikimin e hershëm të viktimave të trafikimit me njerëz nga shërbime konsullore, policia kufitare dhe inspektorati i punës

Ky udhëzim administrativ derivon nga Ligji nr.04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, me qëllim që të përcaktojë treguesit të cilët duhet të merren në konsideratë nga zyrtarët e Shërbimeve Konsullore, të Policisë Kufitare dhe atyre të Inspektoratit të Punës, për identifikimin e hershëm të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit me njerëz. Identifikimi i hershëm i viktimave nga këto institucione ka për qëllim edhe verifikimin e viktimizimit dhe referimin për ndihmë në bazë të vlerësimit të përputhjes së nevojave të viktimës me shërbimet që ekzistojnë e mund të ofrohen për viktimat.

2015

Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Puna dhe procesi për kompensim të viktimave të krimit, ka filluar vite më parë, ku Ministria e Drejtësisë, në Planin Zhvillimor Strategjik për vitin 2012-2016, kishte paraparë që të rregullohet kjo çështje. Ministria e Drejtësisë me ndihmën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, fillimisht hartoi dhe miratoi edhe Koncept Dokumentin i cili dokument përfshiu një analizë të detajuar të adresimit të çështjes së kompensimit të viktimave të krimit ndërkombëtarisht dhe në vend, dhe më pas edhe hartoi Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i cili është miratuar në vitin 2015. Ligji për Kompensimin e Viktimave rregullon themelimin e Komisionit dhe financimin e Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, dhe garanton mundësi për kompensim viktimave të krimit, përkatësisht viktimave të veprave të dhunshme penale si: vrasja; trafikimi me njerëz; dhunimi; keqpërdorimi seksual i fëmijëve; si dhe veprat penale që bien brenda përkufizimit të dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Komisioni i Kompensimit të Viktimave të Krimit ka një përbërje multidisciplinare dhe përfaqësohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, gjyqtari nga Gjykata Supreme, prokurori, aktivisti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, deputeti i Parlamentit të Kosovës dhe 2 mjek nga Oda e Mjekëve të Kosovës, një psikatër dhe një traumatolog. Komisioni i Kompensimit të Viktimave të Krimit u emërua nga Qeveria e Kosovës në shtator të vitit 2016 dhe deri më tani ka

qenë shumë aktiv duke i hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme dhe formularët dhe udhëzuesit për parashtrimin e kërkesës për kompensim. Komisioni në shtator të këtij viti gjithashtu shqyrtoi rastin e parë duke marrë vendim për kompensimin e viktimës së parë, gjegjësisht anëtarit të familjes së viktimës së vrarë për shpenzimet e varrimit dhe poashtu kompensim për vuajtjen shpirtërore si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes.

Rregullorja nr.22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës

Në vitin 2015 u hartua rregullorja për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Kjo rregullore derivon nga Ligji nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, qëllimi i të cilit është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe kriterëve, dhe unifikimi i procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale, gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës si dhe organizimi i punës, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës. Komisioni është i përbërë nga 9 anëtarë: përfaqësuesin nga Zyra e Kryeministrit, Ministria

e Punës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, përfaqësuesi nga institucioni për krime lufte, psikologu klinik, psikiatri, juristi dhe përfaqësuesi ga shoqëria civile me përvojë në veprimtarinë e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës seksuale. Ky Komision është themeluar tashmë vonë dhe ende nuk ka filluar punën e tij, ku ndërkohë janë ndarë edhe fondet për funksionimin për komisionit dhe kompensimit të viktimave të kësaj kategorie. Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës kanë qenë kategoria me e anashkaluar e viktimave nga institucionet shtetërore dhe janë heshtur me vite më rradhë. Sipas shënimeve të organizata joqeveritare të cilat vazhdimisht kanë ofruar mbështetje viktimave, mendohet të jenë diku rreth 20 mijë gra të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Strategjia Kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2015-2019

Strategjia kundër trafikimit me njerëz 2015-2019 u hartua pas vlerësimit të zbatueshmërisë së strategjisë paraprake, i cili proces u koordinua nga Zyra e Koordinatorit Nacional Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz. Grupi ndërministror, partner ndërkombëtar, shoqëria civile dhe grupet tjera të interesit janë përfshirë në vlerësimin gjithpërfshirës dhe të hollësishëm të zbatimit të strategjisë kundër trafikimit me njerëz 2011-2014. Strategjia aktuale reflekton objektivat strategjike në përputhje të plotë me Strategjinë e Bashkimit Europian për Çrrënjosjen e Trafikimit me Njerëz 2012-2016 dhe me adresim të problematikës vendore dhe rajonale. Qëllimi kryesor i strategjisë do të jetë koordinimi i veprimeve parandaluese dhe luftimit kundër trafikimit me njerëz me qëllim të zvogëlimit të

rasteve të trafikimit në Kosovë si dhe koordinimi për ofrimin e shërbimeve cilësore për viktimat e trafikimit duke synuar kthimin e dinjitetit të tyre dhe duke parandaluar ri-trafikimin e tyre.

Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për Dhunë në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014

Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje udhëheqi procesin e vlerësimit të Programit të Kosovës kundër dhunës në familje 2011-2014. Ekspertë vendor dhe ndërkombëtar u angazhuan për të bërë vlerësimin e implementimit të këtij programi dhe veprimet e ndërmara dhe problemet e identifikara gjatë zbatimit të tij. Vlerësimi i Programit është bërë në dy pjesë dhe dy këndvështrime, njëra e fokusuar në aspektin e vlerësimit të ndikimit të programit në të mbijetuarat e dhunës familjare dhe tjetra në vlerësimin e reagimit të sistemit të drejtësisë dhe zbatuesve të ligjit ndaj rasteve të dhunës në familje. Pjesa e dytë e vlerësimit që fokusohet në punën e policies, prokurorëve, gjyqtarëve dhe mbrojtësve të viktimave u realizua nga Prokurorja Amerikane Amy Litëin, vizita e së cilës u mbështet nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Vlerësimi i Programit u publikua në formën e një raporti që i përfshin të dyja vlerësimet dhe rekomandimet e dala nga ky raport shërbyen si bazë për hartimin e Strategjisë së re kundër dhunës në familje. Mesazhi kryesor, e cila doli nga ky raport dhe çoi shumë peshë në publik dhe në mesin e institucioneve që punojnë në këtë drejtim ishte "Zero tolerancë ndaj Dhunës në Familje".

2016

Themelimi i Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit u themelua në shtator të vitit 2016. Komisioni u emrëua me vendimin e Qeverisë dhe sipas Ligjit përbëhet nga gjyqtari nga Gjykata Supreme-si Kryesues i Komisionit, një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, një përfaqësues nga Kuvendi e Republikës së Kosovës, një përfaqësues nga Këshilli Prokurorial, 2 përfaqësues nga Oda e mjekëve të Kosovës- traumatolog dhe psikatër, dhe 1 përfaqësues nga shoqëria civile. Komisioni filloi punën duke hartuar rregulloren e brendshme, formën standarde për kërkesën për kompensim dhe dokumentacionin e nevojshëm për funksionimin e programit. Për herë të parë në Kosovë është formuar komisioni për kompensim të viktimave i cili do të shqyrtojë dhe do të vendosë për kërkesat për kompensim të viktimave në Kosovë. Disa detaje rreth përbërjes dhe punës së Komisionit janë përfshirë edhe me lartë në paragrafin për Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Strategjia e re për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020, është hartuar nën udhëheqjen e Koordinatorit Nacional dhe me kontributin e

grupit ndërministror dhe organizatat ndërkombëtare. Hartimi i Strategjisë është bazuar në raportin vlerësues të strategjisë se mëparshme dhe mbi bazën e rekomandimeve të dala nga ai raport. Strategjia e re ka për qëllim të çojë përpara arritjet nga zbatimi i programit të mëparshëm dhe njëkohësisht duke i plotësuar zbrastësirat e evidentuara gjatë zbatimit të tij. Ngritja e shërbimeve dhe mekanizmave që kanë munguar, përmirësimi i kapaciteteve të profesinistëve për menaxhimin e rasteve me prioritet, vendosja e kryesit përpara përgjegjësisë përmes ashpërsimit të ndëshkimit dhe ndjekjes penale si dhe vetëdijësimi i shoqërisë për reduktimin e tolerancës ndaj dhunës në familje përbëjnë drejtimet kryesore të kësaj strategjie.

Nënshkrimi i protokolleve mes shtetit të Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë për unifikimin e identifikimit dhe referimit të viktimave të trafikimit me njerëz, posaçërisht viktimave fëmijë që janë në lëvizje

Koordinatorët Kombëtar Anti-trafikim me njerëz të Shqipërisë, Kosovës dhe koordinatorit të Malit të Zi, nënshkruan në Tiranë deklaratën e përbashkët të Procedurës Standarde të Veprimit, të unifikuara për identifikimin, referimin, kthimin vullnetar të asistuar dhe mbrojtjen e viktimave, viktimave të mundshme të trafikimit, me fokus të veçantë mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje. Procedurat Standarde të unifikuara, krijojnë bazën e zbatimit të Protokolleve bilaterale mes Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi mbi intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Lëvizjet e pasigurta të fëmijëve dhe familjeve ndërmjet kufijve të rajonit përfshirë Shqipërinë, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë dhe Greqinë, ka çuar në

shfrytëzim të fëmijëve, apo dhe në shfrytëzim për punë të detyruar, lypje dhe trafikim, fenomene që mbeten shqetësuese pavarësisht masave të marra nga secili vend, për parandalimin e shfrytëzimit të fëmijëve, apo lypjes brenda dhe jashtë kufijve.

Adoptimi i Doracakut për gjyqtarë dhe prokurorë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje

Me mbështetjen e Ambasadës Amerikane, Forumi i grave gjyqtare dhe prokurore hartuan dhe publikuan doracakun për gjyqtarë dhe prokurorë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Doracaku ka për qëllim t'iu ndihmojë gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe poashtu edhe profesionistëve tjerë në vlerësimin dhe kuptimin e rasteve të dhunës në familje. Një nga qëllimet parësore të këtij dokumenti është që të sigurojë që praktikat më të mira dhe të njëtrajtshme të zbatohen gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, si në procedurën civile ashtu edhe penale. Doracaku ka përmbajtje të gjërë ku fillimisht përfshinë një kapitull rreth problematikës së dhunës në familje, përkufizimin e tij në bazë të dokumenteve vendore dhe ndërkombëtare, shpjegon dinamikën e dhunës në familje dhe pastaj elaboron trajtimin e rasteve të dhunës në familje në sistemin gjyqësor të Kosovës sa i përket legjislacionit civil dhe urdhrave mbrojtës; procesin penal dhe udhëzimet për caktimin e dënimeve për shkeljen e urdhrave mbrojtës dhe veprave të kryera në kuadër të marrëdhënieve familjare; dënimet alternative dhe programet e intervenimit për kryesit e dhunës në familje.

Hartimi i Indikatorëve për identifikimin formal të viktimave të trafikimit me njerëz

Udhëzimi Administrativ për Listën e Treguesve për identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit me njerëz përcakton listën e treguesve potencial për lehtësimin e identifikimit të viktimave nga autoritetet policore, penale, gjyqësore dhe sociale të cilët mund të jenë në kontakt me viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit me njerëz. Përgjegjës për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ janë autoritetet policore, penale, gjyqësore dhe sociale. Treguesit e identifikimit kategorizohen bazuar në elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz të definuar në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe me Kodin Penal të Kosovës, si vijon: 1/veprimi: rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo pranimin e personave; 2/mjetet: kanosje, përdorimi i forcës, format tjera të shtrëngimit, rrëmbimi, mashtrimi, lajthimi, keqpërdorimi i pushtetit apo i pozitës së ndjeshme, dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër; dhe 3/qëllimi i shfrytëzimit: shfrytëzimi përfshin por nuk kufizohet në shfrytëzimin për prostitucion, pornografi ose forma tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, punë ose shërbime të detyruar, skllavëri dhe veprime të ngjashme të skllavërisë, robëri ose heqja e organeve.

Raporti Greta (Grupi i Ekspertëve për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore), Këshilli Europian

Pas një kërkesë nga autoritetet e Kosovës në Këshillin e Europës për të kryer një vlerësim të kuadrit legjislativ, institucional dhe të politikave në fushën e masave kundër trafikimit me njerëz në Kosovë, në vitin 2014u krijua projekti “Përforcimi i luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë, përmes aplikimit të metodologjisë dhe instrumenteve të GRETA-s”. Objektivi i projektit është përforcimi i kapaciteteve institucionale të Kosovës për të parandaluar dhe luftuar trafikimin me njerëz në përputhje me standardet e Konventës së Këshillit të Europës për Masa kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, përmes një vlerësimi të thellë dhe rekomandimeve për përmirësimin dhe harmonizimin e reformave në këtë fushë. Prandaj për përgatitjen e raportit të vlerësimit, GRETA ka përdorur metodologjinë për vlerësimin e zbatimit të Konventës duke përcjellur një pyetësor në autoriteteve të Kosovës dhe më pas edhe duke realizuar takime direkte në Kosovë me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për luftimin e trafikimit me njerëz dhe misionet ndërkombëtare. Raporti përbën kornizën kombëtare në fushën e masave kundër trafikimit me njerëz në Kosovë, informacion të përgjithshëm për situatën aktuale në fushën e trafikimit me njerëz, kornizën ligjore dhe të politikave, kornizën institucionale dhe vlerësim të përpvetshëm të Kosovës me standardet e Konventës, masat e synuara për parandalimin e trafikimit me njerëz dhe masat për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të viktimave të trafikimit me njerëz dhe rekomandime specifike nga GRETA.

2017

Miratimi i Procedurave Standarde për rritjen e efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje – Prokurorët e caktuar për Dhunë në Familje

Procedurat Standarde të Veprimit kanë për synim ngritjen e efikasitetit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje gjatë procedimit të këtyre rasteve në prokurori që synohet të arrihet përmes caktimit të prokurorëve të veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Secila prokurori themelore ka caktuar prokurorë për t'u specializuar për rastet e dhunës në familje në pajtim me kërkesat që burojnë nga Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020. Specializimi do të ngritë aftësinë për të përmbushur objektivat strategjike që kanë të bëjnë me Koordinatorët e Dhunës në Familje siç parashihet në Shtyllën 3 të Planit të Veprimit të kësaj Strategjie. Specializimi do të mundësojë një çasje më gjithëpërfshirëse, dhe më të koordinuar për të rritur gjasat e ndjekjeve të suksesshme gjersa po ashtu do të mundësojë dhënien e ndihmës viktimave dhe do të sigurojë llogaridhënien e kryerësve. Prokurorët e caktuar për Dhunë në Familje do të trajtojnë të gjitha rastet e dhunës në familje, do të sigurojnë që ato të trajtohen me prioritet, dhe do të shërbejnë për të unifikuar partnerët dhe praktikat e ndryshme në ligjin dhe ndjekjet në rastet e dhunës në familje. Deri më tani të gjitha prokuroritë kanë caktuar nga një prokuror për dhunë në familje nga Departamentnt e Përgjithshme dhe një prokuror

zëvendësues në rastet kur prokurori i caktuar nuk është në dispozicion. Këta prokurorë kanë filluar që t'i pranojnë rastet e dhunës në familje dhe në disa prokurori tashmë merren vetëm më rastet e dhunës në familje.

Funksionalizimi i Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Me 14 Mars 2017, Qeveria e Kosovës miratoi propozim-vendimin e dorëzuar nga Ministria e Drejtësisë për ndarjen e mjeteve financiare për kompensimin e viktimave të krimit, me vlerë prej 100.000 Euro. Pas miratimit të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit në vitin 2015, Ministria e Drejtësisë vazhdimisht kishte kërkuar mjetet financiare që të fillojë procesi i kompensimit të viktimave të krimit, por kjo nuk ishte realizuar asnjherë pasi që Ministria e Financave nuk aprovonte buxhetin e kërkuar gjatë planifikimeve të rregullta buxhetore. Zgjedhjen e fundit, Ministria e Drejtësisë e kishte bërë duke iu drejtuar Qeverisë së Kosovës për ndarjen e një shumë të caktuar së paku deri në fundin e vitit. Përmes këtij procesi, mundësohet kompensimi financiar i viktimave të krimit, përkatësisht viktimave të kategorive të caktuara të veprave penale. E drejta për të parashtruar kërkesë për kompensim nga programi i kompensimit të viktimave filloi menjëherë pas caktimit të mjeteve financiare, dhe viktimat e veprave penale të cekura në Ligj për të cilat ka përfunduar procesi gjyqësor me aktgjykim të plotfuqishëm nga 30 qershori i vitit 2016, kanë të drejtën t'i drejtohen Komisionit për kompensim të viktimave të krimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit për rastin e Zejnepe Bytyqi Berisha

Në tetor të vitit 2015 Zejnepe Bytyqi Berisha nga Suhareka ishte vrarë në mënyrë brutale nga burri i saj Nebih Berisha, i cili e kishte goditur atë 20 herë me thikë në praninë e vajzës së saj e cila ishte poashtu ishte lënduar duke u munduar t'i dalë në ndihmë nënës së saj. Zejnepe Berisha, 16 vite me rradhë kishte përjetuar dhunë sistematike familjare nga burri i saj dhe e kishte denoncuar rastin disa herë në polici. Përkundër gjitha raportimeve, organet shtetërore asnjëherë nuk kishin arritur të ndër marrin hapa serioze për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje. Pas vrasjes së Zejnepës, me urdhër të Gjykatës Themelore të Prizrenit me 12 prill 2017 vrasësi i viktimës ishte dënuar me vetëm 12 vjet burgim. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në nenin 179 mbi Vrasjen e Rëndë thotë se “Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili privon nga jeta anëtarin e familjes(par.1.3)”. Konsideruar rrethanat se si ka ndodhur kjo vrasje, peshën e veprës dhe dhunën sistematike që viktimë ka përjetuar, ky dënim ishte parë si jo proporcional me veprën e kryer. Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si rrethana rrënduese, më pas Gjykata e Apelit e aprovoi ankesën e prokurorisë dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar, duke ndryshuar vendimin mbi dënimin. Gjykata e Apelit, vrasësin e Zejnepe Berishës e ka dënuar me 17 vjet burgim për “Vrasje e rëndë” nga neni 179 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 i të njëjtit kod. Me vendime të drejta, organet e drejtësisë mund të ndikojnë në uljen e dhunës, respektivisht krimit, duke konsideruar se dhuna në familje është krim.

Kompensimi i parë i viktimës së krimit nga Programi i Kompensimit të Viktimave të Krimit

Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit në shtator të këtij viti vendosi për rastin e parë të kompensimit. Komisioni mori vendim për kompensimin e anëtarit të familjes së viktimës së vrasjes për kërkesën e tij për kompensim për shpenzimet e varrimit dhe poashtu kompensim për vuajtjen shpirtërore si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes. Kjo është datë historike në fushën e mbrojtjes së të drejtave të viktimave të krimit në Kosovë, ku për herë të parë shteti e kompenson viktimën për dëmin e shkaktuar si pasojë e veprës penale.

Kjo broshurë është hartuar nga Eliza Shporta, Udhëheqëse e Programit për mbrojtje të viktimave, në kuadër të të Departamentit të Drejtësisë, Ambasada Amerikane në Prishtinë.



